

z. Fikrim Damka
Kryetar i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Kuvendi i Republikës së Kosovës
Prishtinë

29 prill 2013

I nderuar z. Damka,

Lënda: Letër lidhur me Projektligjin për Transplantimin e Organeve.

Po ju shkruaj lidhur me diskutimet në vazhdimësi për Projektligjin për Transplantimin e Organeve, që ndodhet pranë Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Siç jeni të njohur, EULEX-i ka treguar një interesim për komentimin e këtij projektligji dhe ka dorëzuar disa komente të përgjithshme teknike, që kryesisht theksojnë mospërputhjet në mes të sanksioneve administrative dhe sanksioneve penale si dhe dënimet e parashikuara për veprën penale të "Transplantimi i kundërligjshëm dhe trafikimi i organeve dhe qelizave njerëzore", sipas nenit 265 të Kodit Penal të Kosovës.

Megjithatë, shqetësime shtesë mbeten sa i përket synimit të përgjithshëm të këtij projektligji dhe ndikimit që do të mund të ketë në sistemin e shëndetësisë së Kosovës. EULEX-i është vetëm një mision teknik i Sundimit të Ligjit dhe nuk ka kapacitete të komentojë dhe të jep komente të specialistëve për zbatimin dhe realizueshmërinë e këtij ligji në Kosovë. Ne kemi shqetësime se ky projektligj, edhe pse kërkohet për shkak të rritjes së numrit të pacientëve që u duhen trajtime dialize, prapë, shqetësimet e tashme të vlefshme, nëse lejohen klinikat private të marrin leje për të kryer operacione për transplantimin e organeve, do të jetë e vështirë të monitorohen me saktësi nëse procesi është kryer sipas ligjit dhe praktikave më të mira.

Në këtë fazë, ne do ju këshillojmë fuqishëm Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale që të kërkojë asistencë për një vlerësim teknik që duhet t'i bëhet këtij ligji. Në veçanti, EULEX-i i është drejtuar Këshillit të Evropës në Strasburg dhe ka marrë një reagim pozitiv nga Komisioni Evropian për Transplantimin e Organeve, që jep asistencë të ngjashme për një numër shtetesh të Detit të Zi dhe të Amerikës Jugore, Afrikës Veriore dhe shteteve të Lindjes së Mesme. Ekspertët e tyre kanë dhënë këshilla dhe komentuar literaturën në vijim, e cila përmban praktikat më të mira ndërkombëtare në transplantimin e organeve:

(http://www.coe.int/t/dg3/healthbioethic/default_en.asp)

dhe kanë ofruar asistencën e tyre për kontribut të mëtejshëm, nëse kjo u kërkohet. Ne gjithashtu po pyesim edhe organizata të tjera ndërkombëtare siç

EULEX Kosovo

HQ, Farned Building
Muhammed Fejza p.r.
Box: 268, 10000
Prishtina, Kosovo
Tel: (0) 38 78 2000
Fax: (0) 38 78 6556
Email: eulex-kosovo.eu,
eulex-kosovo.eu



është Organizata Botërore e Shëndetësisë për ndonjë kontribut të mundshëm nga ta.

Prandaj, ne ju këshillojmë që para se të ndërmerren hapa të mëtejshëm, të bëhet një vlerësim teknik i duhur si dhe të shikohet realizueshmëria dhe ndikimi potencial i këtij ligji.

Sinqerisht,

Jarmo Helppikangas

Shef i Zyrës Ligjore dhe për të Drejtat e Njeriut

EULEX KOSOVA

www.gazetaexpress.com